UDHËZIM
Nr.1, datë 12.1.2011

PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA TË PRANIMEVE DHE REGJISTRIMIN E APLIKANTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 "Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011",

UDHËZOJ:

1. Të plotësohen kuotat e parealizuara të shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 "Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011", të ndryshuar, pas përfundimit të regjistrimit të aplikantëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, sipas udhëzimit nr.35, datë 5.11.2010 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimit në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011".
2. Të rishpërndahen kuotat e parealizuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2010-2011, sipas programeve të ndryshme të studimeve dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 12:00 të datës 17.1.2011, listat e të gjithë aplikantëve të renditur sipas rendit zbritës të pikëve, të fituara në përputhje me kriteret akademike të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht. Në këto lista të jenë të evidentuar kandidatët fitues, të ndarë sipas programeve të studimeve përkatëse. Nuk pranohen aplikime nga kandidatët e shpallur fitues me formularët A2 dhe A3, të regjistruar në listat përfundimtare.
4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, ku janë shpallur fitues të kryhet në datat 18, 19, 20, 21 janar 2011, prej orës 8:00 deri në orën 16:00 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.
5. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në datën 22.1.2011, listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar. Në lista të evidentohet dokumenti shkollor mbi të cilin është bërë regjistrimi.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Tabela nr.1

RISHPËRNDARJA E KUOTAVE TË PAREALIZUARA TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME, JANAR 2011

Kuota shtese

Programi i studimit			IAL publike				UK		Totali
	UT	UE	UST	UD	UGJ	UBT	P.I	P. II	
Histori-Gjeografi		10							
Histori	20								
Gjeografi	20								
Gjuhe-Letersi	20								
Psikologji	10								
Edukate Qytetare		16							
Cikli i Ulët		20					10		
Cikli i Ulët Parashkollor		20							
Matematikë-Fizikë		10			5				
Biologji - Kimi		10			5				
Punë Sociale	10	10							
Filozofi-Sociologji		16							
Infermieri e pergjithshme		20							
Administrim Biznesi	60								
Finance Kontabilitet	60								
Edukim fizik dhe sporte			90						
Drejtesi	20			50					
Cikel i Ulet (Filiali i Peshkopise)				40					
Drejtesi (Filiali i Peshkopise)				40					
Infermieri e pergjith (Filiali i Peshkopi)				40					
Mbrojtje bimësh						10			
Hortikulturë						10			
Prodhim bimor						10			
Zootekni dhe Biznes Blegtoral						10			
Akuakulturë dhe Menaxh.. Peshkimi						10			
Agromjedis dhe Ekologji						40			
Agromekanizim						10			
Finance								10	
Turizem (Filiali Pogradec)							10		
Totali	**220**	**132**	**90**	**170**	**10**	**100**	**30**		**752**